VENDIM
Nr. 25, datë 21.1.2026

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES EKZEKUTIVE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, PËR REALIZIMIN E NISMËS "FORCIMI I KAPACITETEVE TË MBROJTJES CIVILE NË SHQIPËRI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ekzekutive, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për realizimin e nismës "Forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes civile në Shqipëri", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE EKZEKUTIVE

MIDIS

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE

PËR REALIZIMIN E NISMËS "FORCIMI I KAPACITETEVE TË MBROJTJES CIVILE NË SHQIPËRI"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, në vijim "Shqipëria" dhe Qeveria e Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim (MAECI - DGCS), në vijim "Italia", referuar bashkërisht si "Palët", dhe individualisht si "Pala".

NË BAZË TË Marrëveshjes Kuadër për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, nënshkruar në Tiranë më 2 dhjetor 2008;

DUKE MARRË PARASYSH se nisma bën pjesë në prioritetet e Shqipërisë dhe duke marrë parasysh letrën e kërkesës së Ministrit Shqiptar të Mbrojtjes dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të Shqipërisë, datë 20 dhjetor 2023;

DUKE MARRË PARASYSH se në datën 9 prill 2024 Komiteti i Përbashkët për Bashkëpunimin Zhvillimor të Republikës Italiane miratoi me Rezolutën nr. 30 nismën e bashkëpunimit e quajtur "Forcimi i kapaciteteve të Mbrojtjes Civile në Shqipëri", për një shumë totale donacioni prej 5,000,000.00 (pesë milionë) Euro;

Bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
PËRKUFIZIME

Në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm me kuptimet e tyre përkatëse krah secilit:

Projekti	Nisma "*Përforcimi i kapaciteteve të Mbrojtjes Civile në Shqipëri*";
MAECI - DGCS	Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit

	Ndërkombëtar e Republikës Italiane - Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Zhvillimor;
AICS	Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor;
MF	Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë;
MD	Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë;
ANPC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile Shqiptare;
PIU	Njësia e Zbatimit të Projektit;
SISTAFE	Sistemi Shqiptar i Administrimit Financiar Shtetëror.

Neni 2
STRUKTURA E MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje përbëhet nga 19 Nene dhe dy Shtojca:

   - Shtojca 1 - Dokumenti i Projektit.
   - Shtojca 2 - Klauzola etike dhe parime themelore për lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

2. Shtojcat e sipërpërmendura konsiderohen si pjesë përbërëse e Marrëveshjes. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, kjo Marrëveshje do të mbizotërojë mbi Shtojcat.

Neni 3
OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

1. Projekti synon të kontribuojë në funksionimin e plotë të sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri nëpërmjet përforcimit të aftësive teknike dhe operacionale të sistemit shqiptar të mbrojtjes civile, me qëllim parandalimin dhe trajtimin në mënyrë më efektive të llojeve të ndryshme të emergjencave në territorin shqiptar.

2. Objektivat që duhen ndjekur, rezultatet që pritet të arrihen, si dhe aktivitetet që do të kryhen dhe kostot përkatëse që do të përballohen janë të detajuara në Shtojcën 1.

Neni 4
KONTRIBUTI FINANCIAR I ITALISË

Kontributi i përgjithshëm financiar për realizimin e projektit do të jetë i barabartë me 5,000,000.00 (pesë milionë) euro, financuar nga Italia sipas mënyrave të mëposhtme:

a) 4,850,000.00 (katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) euro do të paguhen në një llogari euro dedikuar projektit, e cila do të hapet në Thesarin e Shtetit të MF-së, siç rregullohet nga kjo Marrëveshje;
b) 150,000.00 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro do të menaxhohen drejtpërdrejt nga AICS me seli në Tiranë dhe do të përdoren për veprime të pavarura të auditimit financiar.

Neni 5
METODAT E LËVRIMIT DHE PËRDORIMIT TË FINANCIMIT ITALIAN

1. Financimi italian i referuar në Nenin 4 gërma a), do të depozitohet në një llogari në Euro, dedikuar Projektit, e hapur në Thesarin e Shtetit të MF-së.

2. Llogaria e dedikuar për Projektin do të përdoret vetëm për financimin e aktiviteteve të parashikuara në Shtojcën 1. Procedurat e kontabilitetit duhet të ndjekin Ligjin e SISTAFE shqiptar.

3. Blerja e mallrave dhe shërbimeve dhe për zbatimin e projektit do të kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në zbatim të Rregullores së Bashkimit Evropian për Procedurat e Dhënies së Kontratës – (PRAG) – dhe Shtojcës 2 ("Klauzolat etike dhe parimet themelore për përcaktimin dhe ekzekutimin e kontratave"), pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Në rast të ndonjë konflikti ndërmjet dispozitave të Shtojcës 2 dhe rregullave të PRAG, do të mbizotërojë Shtojca 2.

4. Për dhënien e kontratave për blerjen e shërbimeve me vlerë më të madhe se 100,000.00 (njëqind mijë) euro dhe për blerjen e shërbimeve dhe kryerjen e punëve civile, në shumën mbi 300,000.00 (treqind mijë) euro, dokumentacioni i tenderit mund të publikohet pas lëshimit të Autorizimit nga AICS. Pasi të përfundojë procedura e vlerësimit, kontratat përkatëse mund të nënshkruhen me autorizimin nga AICS. Nëse kontratat individuale të përcaktuara brenda Projektit kanë një shumë më të ulët se kufijtë maksimalë të treguar, nuk do të jetë e nevojshme të lëshohet Autorizimi i sipërpërmendur. Të gjitha kontratat për blerjen e mallrave, shërbimeve, realizimit të punimeve dhe veprave, si dhe procedurat përkatëse të përzgjedhjes do t'i nënshtrohen auditimit të përmendur në këtë Marrëveshje.

5. Lëvrimi i kontributit financiar italian për Shqipërinë, i përmendur në Nenin 4, do të bëhet në mënyrat e mëposhtme:

   a) Një këst i parë i barabartë me 1,879,000.00 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) euro do të lëvrohet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe miratimit të Planit të parë Operativ të Projektit nga Komiteti Drejtues (KD), sipas Nenit 11.
   b) Një këst i dytë i barabartë me 1,763,750.00 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, do të lëvrohet pas miratimit nga Komiteti Drejtues (KD) i Planit Operativ të Projektit për periudhën e referencës dhe të raportit mbi ecurinë tekniko-financiare të projektit, (të vërtetuar nga shoqëria audituese e përmendur në Nenin 6 vijues) dhe pas shpenzimit të paktën 70% të shumës së këstit të parë të lëvruar;
   c) Një këst i tretë i barabartë me 1,207,250.00 (një milion e dyqind e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro do të lëvrohet pas raportit mbi ecurinë tekniko-financiare të Projektit (të vërtetuar nga shoqëria audituese e përmendur në Nenin 6 vijues) dhe pas shpenzimit të paktën 70% të shumës së këstit të dytë të lëvruar.

Neni 6
RAPORTET PËR ECURINË TEKNIKO-FINANCIARE

1. Selia e AICS në Tiranë do të përzgjedhë kompaninë e auditimit midis atyre me përvojën më të madhe në aktivitete të ngjashme dhe që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, të miratuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) dhe Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Eprore të Auditimit (INTOSAI).

2. Termat e referencës së detyrës do të përcaktohen së bashku nga Palët dhe do të vendosen duke marrë parasysh atë që përcaktohet në Shtojcën 1 dhe duhet të parashikojnë kontrollin e përgjithshëm të aktiviteteve të prokurimit. Përzgjedhja do të bëhet në zbatim të rregulloreve të përcaktuara në paragrafin e mëparshëm. Rezultatet e përzgjedhjes do t'i transmetohen AICS për marrjen e Autorizimit paraprak për shpalljen e fituesit. ANPC-ja do të jetë përgjegjëse për të siguruar arkivimin e duhur dhe të plotë të të gjithë dokumentacionit në lidhje me proceset individuale të prokurimit dhe vënien e tyre në dispozicion për aktivitetet e auditimit.

3. Shumat e pa raportuara duhet të kthehen në Itali.

Neni 7
PËRDORIMI I FONDEVE

1. Fondet, objekt i financimit, do të përdoren ekskluzivisht për:

   a) pagesën e shërbimeve, furnizime, punime dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për realizimin e Projektit dhe në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara në Shtojcën 1;
   b) pagesën për aktivitetet që kanë të bëjnë me auditimin.

2. Fondet e Projektit nuk mund të përdoren për pagimin e tatimeve, taksave, detyrimeve doganore dhe tarifave të tjera.

3. Në rast interesash të përllogaritur, ata duhet të raportohen dhe mund të përdoren për të financuar aktivitete të mëtejshme brenda Projektit, me pëlqimin paraprak të Palëve.

Neni 8
DETYRIMET E PALËS SHQIPTARE

1. Shqipëria do t'i komunikojë Italisë, nëpërmjet ANPC-së, të dhënat bankare të llogarisë rrjedhëse të dedikuar të hapur nga ANPC.

2. Shqipëria, nëpërmjet ANPC-së, do t'i paraqesë në AICS raportet e përmendura në Nenin 11.3.

3. Shqipëria është garantuese për zbatimin e Projektit, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe do të jetë përgjegjëse për të kërkuar përjashtimin nga pagesa e taksave dhe tarifave të tjera doganore.

4. Shqipëria do të duhet të sigurojë që fondet të regjistrohen rregullisht në Buxhetin e Shtetit për vitin e referencës.

5. Shqipëria do të sigurojë që fondet të përdoren për qëllime dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Shtojcave të saj, që ato të mos përdoren, qoftë edhe në mënyrë indirekte, për veprimtari ushtarake dhe që mallrat dhe veprat e realizuara ose të fituara të mos përdoren për qëllime ushtarake, as pas përfundimit të programit. Kjo dispozitë do të mbetet në fuqi edhe pas përfundimit, për çfarëdo arsye, të kësaj Marrëveshjeje.

6. Shqipëria do të lejojë Italinë të kryejë aktivitete të mbikëqyrjes, kontrollit dhe verifikimit të zbatimit të Projektit, duke lejuar, ndër të tjera, aksesin në zonat e Projektit dhe në dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës.

7. Shqipëria do t'i kthejë Italisë fondet e disbursuara sipas kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në Marrëveshjen dhe Shtojcat e saj, si dhe fondet e disbursuara por të pashfrytëzuara në fund të zbatimit të Projektit ose në rastet e përfundimit të parakohshëm të Marrëveshjes.

Neni 9
DETYRIMET E PALËS ITALIANE

Italia merr përsipër të lëvrojë shumën totale të financimit dhuratë të barabartë me 4,850,000.00 (katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) euro sipas mënyrave të përcaktuara në Nenin 5.

Neni 10
LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me legjislacionin italian dhe shqiptar, si dhe me të drejtën ndërkombëtare në fuqi dhe, për sa i përket Palës Italiane, me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian.

Neni 11
MËNYRA E MENAXHIMIT DHE E ZBATIMIT

1. Projekti do të zhvillohet në përputhje me Shtojcën 1 dhe Planet Operative gjashtëmujore të Projektit të miratuara nga Komiteti Drejtues (KD).

2. Komiteti Drejtues (KD) do të përbëhet nga:

   - një përfaqësues i selisë AICS në Tiranë;
   - një përfaqësues i Ambasadës Italiane në Tiranë;
   - një përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (ANPC);
   - një përfaqësues i Njësisë së Zbatimit të Projektit (PIU).

Në seancat e KD-së mund të ftohen edhe përfaqësues të subjekteve të tjera të përfshira. Palët do të takohen, të paktën dy herë në vit, për të verifikuar ecurinë e aktiviteteve të planifikuara - siç përcaktohet nga Planet Operative të Projektit – dhe për të bërë, nëse është e nevojshme, ndryshime në to, si dhe për çdo gjë tjetër që është e nevojshme për funksionimin me korrektësi të Projektit.

3. Menaxhimi i Projektit do të sigurohet nga Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) e përbërë nga anëtarë teknikë të përzgjedhur në përputhje me dispozitat e Rregullores së Bashkimit Evropian për Procedurat e Dhënies së Kontratës – (PRAG) –. Ajo do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e Planeve Operative të Projektit, të Raporteve Teknike-Financiare gjashtëmujore, Raporteve mbi ecurinë tekniko-financiare të kërkuar për lëvrimin e kështit të dytë dhe të tretë dhe për Raportin Përfundimtar të Mbylljes së projektit, - përfshirë zhvillimin e Termave të Referencës për kontraktimin e shërbimeve, punëve dhe mallrave - dhe për zbatimin e vendimeve të marra nga KD.

4. Rishpërndarjet dhe rregullimet ndërmjet zërave individualë, brenda kapitujve të shpenzimeve, mund të kryhen gjatë përgatitjes së Planeve Operative të Projektit dhe të miratuara nga KD.

5. Ndryshimet, rritjet ose zvogëlimet ndërmjet kapitujve të shpenzimeve (përbërësit e Projektit), që tejkalojnë 20% për kapitull, mund të bëhen në Projekt pas përgatitjes, nga ANPC, të një propozimi të arsyetuar dhe marrjes të Autorizimit teknik përkatës nga AICS.

6. Për çdo gjë që nuk parashikohet shprehimisht, do t'i bëhet referim tekstit të Shtojcës 1.

Neni 12
SHKAQE PENGUESE DHE FORCA MADHORE

1. Në rast të konfliktit të armatosur, fatkeqësive natyrore, grevave ose cenimeve të rendit publik që e bëjnë të pamundur zbatimin e Projektit dhe/ose që përbëjnë shkaqe rreziku për sigurinë dhe paprekshmërinë e personelit të huaj dhe vendas të përfshirë në zbatimin e tij, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:
   a) Në rast se kohëzgjatja e pengesës për realizimin e projektit është më pak se (6) gjashtë muaj, lëvrimi i fondeve për kryerjen e aktiviteteve të planifikuara do të pezullohet dhe fondet e mbetura do të ngrijnë deri në përfundimin e shkaqeve penguese dhe kur AICS të ketë autorizuar rifillimin e aktiviteteve të Projektit;
   b) Në rast se kohëzgjatja e pengesës për realizimin e projektit është më e madhe se (6) gjashtë muaj dhe më pak se (12) dymbëdhjetë muaj, projekti do të pezullohet dhe fondet e mbetura - me përjashtim të atyre që lidhen me aktivitetet e përmendura në paragrafin 2 vijues - do të mbahen deri në zhdukjen e shkaqeve penguese. Pasi të jenë zhdukur shkaqet penguese për kryerjen normale të aktiviteteve të Projektit, ANPC do t'i paraqesë AICS një plan të ri aktiviteti, i cili do të miratohet nga KD dhe sipas të cilit do të rifillojë zbatimi i Projektit;
   c) Nëse shkaqet penguese vazhdojnë për një periudhë më të madhe se dymbëdhjetë (12) muaj, secila Palë mund ta anulojë këtë Marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike duke e njoftuar Palën tjetër tre (3) muaj përpara.

2. Veprimtaritë që kryhen në vende që nuk preken nga shkaqet penguese të përmendura në pikën e mëparshme të këtij neni, do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre.

Neni 13
PARANDALIMI I PËRDORIMIT TË PALIGJSHËM TË FONDEVE

1. Palët angazhohen në mënyrë të vendosur për të parandaluar dhe identifikuar praktikat mashtruese dhe korruptive. Palët garantojnë që përdorimi i Kontributit Italian është në përputhje me standardet më të larta të sjelljes etike dhe se çdo organ dhe institucion i përfshirë në zbatimin e projektit respekton standardet më të larta të etikës dhe integritetit.

2. Palët, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare përkatëse, do të garantojnë që çdo pretendim për mashtrim dhe korrupsion në lidhje me zbatimin e Projektit t'u raportohet menjëherë autoriteteve kombëtare përkatëse. Pretendimet e besueshme do të hetohen nga autoritetet kompetente të Palëve në përputhje me ligjet, rregulloret, rregullat, politikat, procedurat dhe praktikat e mira të tyre përkatëse kombëtare. Palët do të informojnë njëra-tjetrën, në kohën e duhur dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare përkatëse, për rezultatin e pretendimeve të vërtetuara për mashtrim dhe korrupsion dhe detajet e veprimeve të ndërmarra.

3. Pas përfundimit të çdo hetimi që identifikon mashtrimin ose korrupsionin në lidhje me çdo aktivitet të financuar tërësisht ose pjesërisht me Kontributin Italian të parashikuar në këtë Marrëveshje, është rënë dakord që:
   (a) Palët do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rikuperuar çdo pjesë të Kontributit që Autoriteti Kombëtar përkatës përcakton se është devijuar nëpërmjet mashtrimit ose korrupsionit;
   (b) Në lidhje me pikën (a) më sipër, Palët do t'ia referojnë çështjen Autoriteteve kompetente të shtetit ku besohet se ka ndodhur mashtrimi ose korrupsioni; dhe
   (c) me kërkesë të Italisë dhe pas konsultimeve ndërmjet Palëve, Shqipëria do të rimbursojë Palën Italiane për çdo pjesë të Kontributit të mësipërm, ose do ta kreditojë atë në një aktivitet të rënë dakord ndërmjet Palëve.

Neni 14
PEZULLIMI I LËVRIMIT TË KREDISË NGA ITALIA

1. Italia rezervon të drejtën të pezullojë lëvrimin e financimit në rastet e mëposhtme:
   a) Në rast se Pala Shqiptare kryen mospërmbushje të rëndë;
   b) Nëse verifikohen fakte që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit të parashikuar në nenin 12.

2. Përbëjnë shkelje të rëndë:
   a) mosfillimi i aktiviteteve brenda gjashtë (6) muajve nga lëvrimi i financimit të përmendur në Nenin 4;
   b) vonesa të zgjatura dhe të pajustifikuara në përdorimin e financimit italian, që

mund të rrezikojë kryerjen e aktiviteteve të planifikuara;

c) përdorimi i financimit italian për aktivitete të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Projekti;
d) parregullsi të rënda në menaxhimin e financimit italian, të vërtetuara nga auditimi i përmendur në Nenin 6 si më sipër.

3. Italia do të njoftojë Shqipërinë me një Notë Verbale për pezullimin e financimit. Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi, kjo e fundit nuk e ka hequr pengesën për vazhdimin e Projektit, Palët do të konsultohen për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme. Në mungesë të një zgjidhjeje, Pala Italiane mund të anulojë këtë Marrëveshje.

Neni 15
ANULIMI I MARRËVESHJES

Të dyja palët munden, në çdo kohë, të anulojnë këtë Marrëveshje, me një njoftim paraprak prej tre (3) muajsh. Synimi për të anuluar Marrëveshjen do t'i njoftohet palës tjetër me anë të një Note Verbale, duke treguar arsyet që justifikojnë faktin se nuk mund të vazhdohet me zbatimin e Projektit. Në rast të përfundimit të parakohshëm të Marrëveshjes, në lidhje me kthimin e fondeve të papërdorura Palës Italiane do të zbatohet Neni 8.7.

Neni 16
AMENDAMENTET

Të dyja palët mund të bëjnë në çdo kohë ndryshime në këtë Marrëveshje dhe Shtojcat e saj duke shkëmbyer Nota Verbale, të cilat do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së Notës Verbale si përgjigje.

Neni 17
MOSMARRËVESHJET

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve që lind nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, duhet të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.

Neni 18
NJOFTIMET

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, janë specifikuar adresat e mëposhtme:

- për Ministrinë e Mbrojtjes: informimi_mm@mod.gov.al, anisa.hoxha@mbrojtja.gov.al;
- për ANPC – Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile: info@akmc.gov.al, klajdi.nikolla@akmc.gov.al, Rruga e Dibrës, Garnizoni "Skënderbej";
- për MAECI-DGCS - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit

ANEKSI 2

KLAUZOLAT ETIKE DHE PARIMET THEMELORE PËR LIDHJEN DHE EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

Ky aneks përcakton klauzolat etike dhe parimet themelore të cilave u përmbahet lidhja dhe ekzekutimi i kontratave të furnizimit, shërbimit dhe punimeve të parashikuara nga Marrëveshja. Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë aneks, zbatohet legjislacioni referues i përcaktuar nga Marrëveshja.

1. KËRKESAT E KONTRAKTORIT

1.1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në Marrëveshje, procedurat për zgjedhjen e kontraktorit janë të hapura për operatorët ekonomikë nga Bashkimi Evropian, për ata të përmendur në nenin 25 të Direktivës 2014/24/BE dhe për ata që zotërojnë kërkesat dhe autorizimet e kërkuara nga legjislacioni vendas.

1.2. Autoriteti kontraktor mund të vendosë një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme të pjesëmarrjes për operatorët ekonomikë, me kusht që ato të jenë të lidhura dhe në proporcion me objektin e kontratës:

1.2.1. *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*: autoriteti kontraktor mund të vendosë kërkesa për të siguruar që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për të realizuar kontratën. Për këtë qëllim, autoriteti kontraktor mund të kërkojë veçanërisht që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro të caktuar minimale vjetore, duke përfshirë një xhiro minimale të caktuar në sektorin e veprimtarisë që mbulon kontrata. Qarkullimi minimal vjetor që operatorët ekonomikë duhet të kenë nuk e kalon dyfishin e vlerës së parashikuar të tenderit, me përjashtim të rrethanave të justifikuara siç duhet në lidhje me rreziqe specifike që lidhen me natyrën e punimeve, shërbimeve ose furnizimeve. Për kontratat e ndara në lote, ky paragraf zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë xhiron minimale vjetore që duhet të kenë operatorët ekonomikë në lidhje me grupet e loteve në rast se fituesit i jepen më shumë lote për t'u kryer njëkohësisht.

1.2.2. *Kapaciteti teknik dhe profesional*: autoriteti kontraktor mund të vendosë kërkesa për të siguruar që operatorët ekonomikë të zotërojnë burimet njerëzore dhe teknike dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me një standard të përshtatshëm cilësie. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë, në veçanti, që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm eksperience të provuar nga referenca të përshtatshme në lidhje me kontrata të ekzekutuara më parë, duke përfshirë këtu edhe privatët. Në procedurat e tenderit për furnizime që kërkojnë punë, shërbime ose punime për vendosje ose instalim, aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të kryer këto shërbime mund të vlerësohet duke iu referuar kompetencës, efikasitetit, përvojës dhe besueshmërisë së tyre.

1.2.3. *Kualifikimi për të kryer veprimtari profesionale*: autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të jenë regjistruar në një regjistër profesional ose tregtar, të mbajtur në shtetin në të cilin ata janë të stabilizuar ose të inkorporuar.

1.3. Dokumentet e tenderit tregojnë kushtet e kërkuara të pjesëmarrjes, të cilat mund të shprehen si nivele minimale të kapacitetit, dhe mjetet e duhura provuese.

1.4. Nëse një operator ekonomik mbështetet në aftësitë e subjekteve të tjera përsa u përket kritereve që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, autoriteti kontraktor kërkon që operatori ekonomik dhe subjektet e mësipërme të jenë bashkërisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

1.5. Në rastin e tenderave për punime, për shërbime dhe operacionetë vendosjes, ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti kontraktor tregon në dokumentet e tenderit detyrat thelbësore që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga vetë ofertuesi ose, në rastin e një oferte të paraqitur nga një grupim operatorësh ekonomikë, nga një pjesëtari grupimit.

1.6. Janë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e tenderit dhe nuk mund të fitojnë, ose të lidhin kontratat përkatëse konkurrentët të cilët:

1.6.1. janë dënuar me vendim të formës së prerë për një nga arsyet e mëposhtme, siç përcaktohet në nenin 57 paragrafi 1 të Direktivës 2014/24/BE: pjesëmarrje në një organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, vepra terroriste ose vepra që lidhen me aktivitete terroriste, pastrim parash, të cilat vijnë nga veprimtaria kriminale, ose financimi i terrorizmit, shfrytëzimi i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikut njerëzor;
1.6.2. janë dënuar me një dënim të formës së prerë për çdo krim tjetër që rezulton, si një dënim plotësues, në pamundësinë për të lidhur kontratë me administratën publike të njërës prej Palëve në këtë Marrëveshje ose të Shtetit në të cilin ato janë vendosur, ose inkorporuar;
1.6.3. kanë kryer shkelje të rënda të vërtetuara përfundimisht të detyrimeve në lidhje me pagesën e tatimeve, ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, nëse kjo është vëndosur me një vendim gjyqësor, ose administrativ me efekt përfundimtar dhe detyrues në njërën nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin ato janë vendosur, ose inkorporuar;
1.6.4. kanë kryer shkelje serioze dhe të vërtetuara përfundimisht të detyrimeve në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, ligjin mjedisor, social dhe të punës në njërën nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin në të cilin janë vendosur, ose inkorporuar;
1.6.5. janë në një nga situatat e mëposhtme ose janë objekt procedimi për verifikim falimentimi, likuidim administrativ të detyrueshëm, likuidim të përkohshëm, pranim në vendosjen e masave të përkohshme të falimentit me vazhdimësi biznesi, ose ndodhen në një situatë të ngjashme;
1.6.6. janë gjetur fajtorë për shkelje të rënda profesionale, të cilat autoriteti kontraktues është në gjendje t'i vërtetojë me mjetet e duhura, të tilla që të vënë në dyshim integritetin ose profesionalizmin e tyre;
1.6.7. janë, ata ose subjektet që i përkasin të njëjtit grup ligjor, anëtarë të konsorciumeve, shoqatave të përkohshme dhe nënkontraktorëve, në konflikt interesi lidhur me pjesëmarrjen e tyre në procedurën e tenderit, për shkak se kanë

dhënë këshilla për autoritetin kontraktor,subjektin kontraktor, ose ndryshe kanë marrë pjesë në përgatitjen e procedurës së dhënies së tenderit;
1.6.8. kanë bërë deklarata të rreme pranë autoriteteve të një prej Shteteve Palë në këtë Marrëveshje në procedurën në vazhdim dhe në dhënien e nënkontraktimeve në dhënien e informacionit të kërkuar për të verifikuar mungesën e arsyeve për përjashtimin ose përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes, kanë fshehur një informacion të tillë, ose janë regjistruar në regjistrin e mbajtur nga Observatori i Autoritetit Qendror Antikorrupsion i Republikës Italiane për deklarata të rreme, ose dokumenta të falsifikuara me qëllim lëshimin e certifikatës së kualifikimit.
1.6.9. janë prekur nga një shkak mosushtrimi i një të drejte, pezullimi ose ndalimi i parashikuar nga legjislacioni i dy Palëve Kontraktuese në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit;
1.6.10. i janë nënshtruar, për kundërvajtje administrative që rrjedhin nga krime të konstatuara me efekt përfundimtar dhe detyrues në njërën nga Palët e kësaj Marrëveshjeje ose në shtetin ku janë vendosur, ose inkorporuar, një sanksioni që përfshin ndalimin e kontraktimit me administratën publike,
1.6.11. kanë shkelur ndalimet e kontratës së mirëbesimit të parashikuara nga legjislacioni i njërës prej dy Palëve Kontraktuese në lidhje me kontrollin e regjistrimeve ndaj palëve të treta në shoqëritë e besimit;
1.6.12. nuk janë në përputhje me rregullat që rregullojnë të drejtën për punë të personave me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit të vendit të cilit autoriteti kontraktor i përket;
1.6.13. janë në lidhje me një pjesëmarrës tjetër në të njëjtën procedurë dhënieje kontrate, në një situatë kontrolli ose në çdo marrëdhënie, edhe faktike, nëse situata e kontrollit ose marrëdhënia nënkupton që ofertat i atribuohen një qendre të vetme vendimmarrëse;
1.6.14. kanë lidhur kontrata pune në varësi, ose të vetëpunësuar dhe, në çdo rast, u kanë ngarkuar detyra ish punonjësve të autoritetit kontraktor, të cilët kanë ndërprerë marrëdhënien e tyre të punës më pak se tre vjet më parë dhe që në tre vitet e fundit të shërbimit kanë ushtruar kompetenca autoritative ose negociuese në emër të të njëjtit autoritet kontraktor ndaj të njëjtit operator ekonomik.

1.7. Një operator ekonomik duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e tenderit edhe nëse arsyet e përjashtimit të parashikuara në paragrafin 1.6 kanë të bëjnë me një anëtar të bordit administrativ, drejtues, ose mbikëqyrës të atij operatori ekonomik, ose një person që ka kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje, ose kontrolli në të.

2. PROCEDURAT E ZGJEDHJES SË KONTRAKTORIT

2.1. Dhënia dhe ekzekutimi i tenderave për punë, shërbime, furnizime dhe koncesione garantojnë cilësinë e shërbimeve dhe kryhen në përputhje me parimet e rezultatit, besimit, aksesit në treg, mirëbesimit dhe mbrojtjes së besimit, autonomisë kontraktuale, ruajtjes së ekuilibrit kontraktual, rreptësisë së shkaqeve të përjashtimit dhe pjesëmarrjes maksimale. Në dhënien e tenderave dhe koncesioneve, autoritetet kontraktore respektojnë edhe parimet e ekonomisë, efektivitetit, afatit dhe korrektësisë, konkurrencës së lirë, mosdiskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, si dhe reklamës. Parimi i ekonomisë mund t'u nënshtrohet, brenda kufijve që lejohet shprehimisht nga ligjet në fuqi, kritereve të parashikuara në tender, të frymëzuara nga

nevojat sociale, si dhe mbrojtjes së shëndetit, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, edhe nga pikëpamja energjetike.

2.2. Konceptimi i procedurës së tenderit ose koncesionit nuk mund të ketë synimin e kufizimit artificial të konkurrencës, me qëllim favorizimin ose mosfavorizimin e parregullt të operatorëve të caktuar ekonomikë ose të disapunimeve, furnizimeve ose shërbimeve të caktuara.

2.3. Kriteret për pjesëmarrje në tendera duhet të jenë të tilla që të mos përjashtojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

2.4. Dokumentacioni i tenderit specifikon shumën e përdorur si bazë për tenderin për kontratën që do të jepet. Ofertat për shuma më të larta përjashtohen automatikisht.

2.5. Procedura e përzgjedhjes së kontraktorit anulohet nëse dorëzohen më pak se tre aplikime/oferta të përshtatshme. Nëse kushtet objektive të tregut e bëjnë shumë të pamundur paraqitjen e tre ofertave të përshtatshme, njoftimi i tenderit mund të lejojë dhënien e kontratës edhe me një ose dy oferta të vlefshme.

2.6. Çdo konkurrent nuk mund të paraqesë më shumë se një ofertë. Në paraqitjen e ofertës së tyre në tender, konkurrentët deklarojnë se nuk kanë ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe se nuk kanë ndonjë lidhje specifike me konkurrentë të tjerë ose me palë të tjera të përfshira në cilësi të ndryshme në projekt.

2.7. Në mungesë të autorizimit të shprehur në dokumentacionin e tenderit, nuk autorizohen variante të ofertës. Variantet janë të lidhura me objektin e tenderit.

2.8. Për pjesëmarrjen në procedurat e përzgjedhjes që i nënshtrohen miratimit të AICS, autoriteti kontraktor u kërkon ofertuesve të japin një garanci për një shumë të barabartë me 2% të shumës së tenderit. Garancitë mund të jenë bankare ose sigurimesh, duhet të parashikojnë heqjen dorë të shprehur të përfitimit të zbatimit paraprak të debitorit kryesor dhe të jenë funksionale me kërkesë të thjeshtë me shkrim nga autoriteti kontraktor. Garancia zbatohet në rast mosnënshkrimi të kontratës që i atribuohet fituesit të tenderit. Autoriteti kontraktor mund të zvogëlojë në mënyrë të arsyetuar shumën deri në 1%, ose ta rrisë atë deri në 4% për ta bërë shumën e garancisë proporcionale dhe të përshtatshme me natyrën e shërbimeve objekt caktimi dhe shkallën e rrezikut që lidhet me të.

3. EKZEKUTIMI I KONTRATAVE

3.1. Ekzekutimi i kontratave për kontratat që do të nënshkruhen pas një procedure përzgjedhjeje që i nënshtrohet miratimit nga AICS është e garantuar me një garanci normalisht të barabartë me 10% të shumës së kontratës. Garancitë mund të jenë bankare ose sigurimesh, duhet të parashikojnë heqjen dorë të shprehur të përfimit të zbatimit paraprak të debitorit kryesor dhe të jenë funksionale me kërkesë të thjeshtë me shkrim nga autoriteti kontraktor. Garancitë për ekzekutimin e kontratës duhet të parashikojnë, në dokumentacionin e tenderit, zbatimin në rast mashtrimi ose mospërmbushjeje të rëndë nga ekzekutuesi. Garancitë e ekzekutimit lirohen në mënyrë progresive në bazë

të ecurisë së ekzekutimit dhe në çdo rast deri në maksimum 80% të shumës së garantuar. Pjesa e mbetur prej 20% lirohet pas verifikimit të ekzekutimit të rregullt.

3.2. Kontratat mund të modifikohen gjatë ekzekutimit me miratimin paraprak të AICS dhe brenda kufijve të përcaktuar nga neni 72 i Direktivës 2014/24/BE. Shuma e ndryshimeve në asnjë rast nuk mund të tejkalojë burimet e përgjithshme financiare të parashikuara për zbatimin e Marrëveshjes. Miratimi i ndryshimeve mund të refuzohet nëse ato e bëjnë të pamundur ose jashtëzakonisht të pamundur ekzekutimin e të gjithë komponentëve të nismës së parashikuar nga Marrëveshja. Kontraktorët nuk kanë të drejtë për asnjë pagesë ose rimbursim për modifikimet e kryera pa autorizim paraprak nga AICS. Me kërkesë të AICS ose autoritetit kontraktor, fituesi i tenderit me shpenzimet e tij rivendos situatën në gjendje të pacenuar.

3.3. Autoriteti kontraktues, nëse gjatë ekzekutimit bëhet e nevojshme të rritet ose të ulet performanca deri në një të pestën e shumës së kontratës, mund t'i imponojë kontraktuesit ekzekutimin me të njëjtat kushte të parashikuara në kontratën origjinale. Në këtë rast kontraktori nuk mund ta zgjidhë kontratën.

3.4. Kontratat nuk mund t'u kalohen palëve të treta, në të kundërt kontrata do të zgjidhet.

3.4. bis Transferimi është i pranueshëm, pas marrjes së miratimit të AICS, vetëm nëse kontraktori fillestar do të marrë vendin e tij, për shkak të vdekjes ose pas ristrukturimit të shoqërisë duke përfshirë këtu mbledhjen e të dhënave ekonomike, bashkimet, ndarjet, blerjen ose falimentimin, nga një operator tjetër ekonomik që plotëson kriteret e përzgjedhjes cilësore të përcaktuar fillimisht, vetëm nëse kjo nuk sjell ndryshime të tjera thelbësore kontratës dhe nuk ka për qëllim shmangien e zbatimit të këtij aneksi.

3.5. Kohëzgjatja e kontratës mund të ndryshoht vetëm për kontratat në proces, nëse në dokumentet e tenderit parashikohet një opsion zgjatjeje. Në këtë rast kontraktori kërkohet të kryejë shërbimet e parashikuara në kontratë me të njëjtat çmime, marrëveshje dhe kushte ose më të favorshme për autoritetin kontraktor.

3.6. Pa cenuar respektimin e detyrimeve të gjurmueshmërisë të përmendur në paragrafin 3.9, transfertat e kredive sipas tarifave të tenderit, koncesionit dhe konkursit të projektimit janë efektive dhe të kundërshtueshme ndaj qeverisë italiane vetëm me miratimin paraprak të AICS. Në çdo rast, autoriteti kontraktor, të cilit i është njoftuar transferimi, duhet të rezervojë të drejtën të ngrejë ndaj marrësit të gjitha kundërshtimet që mund të ngrihen për transferuesin në bazë të kontratës në lidhje me punimet, shërbimet, furnizimet dhe planifikimin të nënshkruar me të.

3.7. Titullarët e ngarkuar me detyrën e projektimit janë përgjegjës për dëmet e pësuar nga autoritetet kontraktore si rezultat i gabimeve ose mosrealizimit të projektit. Në rastin e tenderave me objekt projektimin ekzekutiv dhe ekzekutimin e punimeve, kontraktori është përgjegjës për vonesat dhe kostot që vijnë nga nevoja për të bërë ndryshime për shkak të mangësive në projektin ekzekutiv.

3.8. Dokumentacioni i tenderit specifikon kushtet e nënkontraktimit. Konkurrentët duhet të deklarojnë, në ofertat e tyre, cilat furnizime, shërbime ose punë synojnë të nënkontraktojnë. Fituesit e tenderit depozitojnë kontratat e nënkontraktimit pranë autoritetit kontraktor përpara fillimit të punimeve objekt nënkontraktimi. Kontraktorët

kryesorë marrin përgjegjësinë e plotë për të gjithë kontratën ndaj autoritetit kontraktor. Nënkontraktorët duhet të zotërojnë kërkesat e përcaktuara në përputhje me paragrafin 1.2 për me shërbimet që do të duhet të kryejnë dhe të mos ndeshen me arsyet e përjashtimit të parashikuara në paragrafët 1.6 dhe 1.7. Konkurrenti ose kontraktori zëvendëson nënkontraktorët që kanë arsye për përjashtim.

3.9. Çmimet e kontratës shprehen dhe paguhen në euro ose në monedhë të ndryshme të parashikuar shprehimisht në Marrëveshje. Rreziqet dhe ndryshimet në kursin e këmbimit në këtë rast nuk do t'i nënshtrohen asnjë kompensimi.

3.10. Pagesat kryhen duke përdorur metoda të gjurmueshme, sipas afateve të përcaktuara kontraktuale të cilat marrin parasysh ecurinë reale të ekzekutimit. Qeveria italiane kryen akreditimet për Palën tjetër Kontraktuese të parashikuar nga Marrëveshja në një llogari bankare të dedikuar vetëm për ekzekutimin e Marrëveshjes. Në kontrata është përfshirë një klauzolë që detyron kontraktorin, nënkontraktorët dhe palë që angazhohet nga nënkontraktori të përdorin një llogari bankare të dedikuar për pagesa.

3.11. Kontrata zgjidhet automatikisht nëse fituesit e kontratës i nënshtrohen procedurave të falimentimit, likuidimit të detyrueshëm, administrimit gjyqësor, ose administrimit të përkohshëm, ose gjenden në një situatë të ngjashme sipas një procedure të parashikuar nga legjislacioni kombëtar përkatës.

3.12. Në rastin e dashjesose fajit të rëndë, nuk lejohet kufizimi i përgjegjësisë së kontraktorëve, nënkontraktorëve, apo palëve që angazhohen nga nënkontraktori.

3.13. Ekzekutimi i kontratës rregullohet nga ligji kombëtar i autoritetit kontraktor, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Marrëveshje dhe në këtë Aneks.

3.14. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ofertuesve të suksesshëm dhe autoritetit kontraktor nuk i nënshtrohen juridiksionit italian.

3.15. Dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë parimet e sipërpërmendura.

4. SHPENZIMET E PRANUESHME DHE TE PAPRANUESHME

4.1. Kostot e zbritura në kontrata janë të pranueshme nëse janë aktuale, të përshtatshme dhe të nevojshme për të realizuar projektin sipas dokumentit të projektit.

4.2. Në çdo rast, nuk janë të pranueshme kostot që kanë të bëjnë me:

4.2.1. mallra jo të domosdoshme ose luksi;

4.2.2. mallra, shërbime dhe punë civile të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me aktivitete ushtarake;

4.2.3. taksa, detyrime indirekte, duke përfshirë TVSH-në, dhe detyrimet doganore që mund t'i detyrohen shtetit të cilit i përket autoriteti kontraktor;

4.2.4. amortizimin e borxheve të kontraktuara më parë dhe humbjet e ardhshme të autoritetit kontraktues ose përdoruesve fundorë;

4.2.5. interesa që nga autoriteti kontraktor ose përdoruesit fundorë u detyrohen palëve të treta.

5. KLAUZOLAT ETIKE

5.1. Çdo përpjekje e konkurrentëve (potencialë ose jo) për të marrë informacione konfidenciale, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentë të tjerë, ose për të ndikuar tek autoriteti kontraktor në fazat e analizës, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, sjell përjashtimin e konkurrentit nga tenderi dhe, si pasojë, eliminimin e ofertës së tij.

5.2. Personeli që punon në administratën publike të Palëve Kontraktuese në Marrëveshje, pavarësisht nga pozicioni specifik administrativ në të cilin ndodhen, nuk mund të punësohet si ekspertë ose konsulentë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender.

5.3. Fituesit e tenderit duhet të veprojnë gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe si këshilltarë besnikë, në përputhje me kodin e sjelljes së profesioneve përkatëse. Ata nuk bëjnë deklarata publike për projektin apo shërbimet e kërkuara prej tyre, pa miratimin paraprak nga autoriteti kontraktor. Në çdo rast, ato nuk e detyrojnë në asnjë mënyrë autoritetin kontraktues pa pëlqimin paraprak me shkrim të tij.

5.4. Për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës, fituesit e tenderit respektojnë të drejtat e njeriut dhe angazhohen të mos cenojnë parimet, traditat dhe zakonet politike, kulturore dhe fetare të vendit përfitues. Në veçanti, fituesit e kontratave respektojnë standardet themelore të punës të përcaktuara nga konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në fuqi për vendin partner dhe për Italinë. Në çdo rast, sigurohet respektimi i dispozitave të "Konventës për lirinë sindikaliste dhe mbrojtjen e së drejtës sindikaliste", "Konventës për të drejtën për organizim dhe bisedime kolektive", të "Konventës për punën e detyrueshme", të plotësuara nga Protokolli i vitit 2014, të "Konventës për diskriminimin (punësim dhe profesion)", dhe "Konventës mbi format me të këqija të punës së të miturve", "Konventës për mbrojtjen e amësisë", të"Konventës për sigurinë dhe shëndetin në bujqësi" dhe të "Konventës kuadër për sigurinë në punë dhe shëndetin".

5.5. Fituesit e tenderit nuk pranojnë pagesa të lidhura me kontratën, përveç atyre të parashikuara në të. Fituesit e tenderit nuk kryejnë asnjë aktivitet dhe as përfitojnë ndonjë avantazh nga autoriteti kontraktor që nuk është në përputhje me detyrimet kontraktore përkatëse.

5.6. Fituesit e tenderit ruajnë sekretin profesional gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe gjithashtu pas përfundimit të saj. Të gjitha raportet dhe dokumentet e hartuara ose të marra nga fituesi i tenderit janë konfidenciale.

5.7. Fituesit e tenderit shmangin çdo marrëdhënie që mund të rrezikojë pavarësinë e tyre ose të stafit të tyre ose ndonjë konflikt tjetër interesi. Nëse fituesit e tenderit pushojnë së qeni të pavarur ose shfaqen konflikte interesi gjatë ekzekutimit, fituesit e tenderit informojnë menjëherë autoritetin kontraktor. Autoriteti kontraktor mund ta zgjidhë kontratën pa paralajmërim dhe pa qenë në gjendje fituesi i tenderit të paraqesë pretendime për kompensim për dëmet.

5.8. Qeveria italiane rezervon të drejtën të pezullojë ose anulojë financimin e projektit, nëse në çdo fazë të procedurës së caktimit të fituesit do të shfaqen praktika korruptive

të çdo lloji dhe nëse autoriteti kontraktor nuk ka mundur të marrë të gjitha masat e duhura për të korrigjuar situatën e krijuar. Për qëllimet e kësaj klauzole, "praktika korruptive" janë ofertat e ryshfetit, dhuratave, donacioneve ose komisioneve, si një nxitje ose shpërblim për çdo person për kryerjen ose abstenimin nga kryerja e çdo veprimi që lidhet me dhënien ose zbatimin e një kontrate të lidhur tashmë me autoritetin kontraktor.

5.9. Dokumentacioni i tenderit dhe kontratat përfshijnë një klauzolë që parashikon anulimin e tenderit ose zgjidhjen e kontratës tashmë të lidhur, edhe nëse është në proces ekzekutimi, ose tashmë e ekzekutuar, nëse dhënia ose ekzekutimi i kontratës ka shkaktuar shpenzime të pazakonta tregtare. "Shpenzime të pazakonta tregëtare" janë komisionet që nuk përmenden në kontratën kryesore, ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur siç duhet dhe që i referohen kontratës kryesore, komisionet e paguara jo si rezultat i shërbimeve të ligjshme dhe realisht të kryera, komisionet e paguara në një parajsë fiskale, komisionet e paguara për një përfitues të identifikuar në mënyrë të paqartë, ose komisionet e paguara për një kompani fiktive.

5.10. Fituesit e tenderit, me kërkesë të AICS, ofrojnë elemente prove, për të shpjeguar kushtet në të cilat është ekzekutuar kontrata. Autoritetet kompetente të Republikës Italiane mund të kryejnë çdo kontroll, të dokumentacionit ose në terren, që ata e gjykojnë të nevojshme për të mbledhur elemente prove në rastet e dyshimeve për shpenzime të pazakonta tregtare ose për praktika të dyshuara korruptive.

5.11. Fituesit e tenderit që kanë paguar shpenzime të pazakonta tregtare në projekte të financuara nga fondet italiane i nënshtrohen, në varësi të seriozitetit të fakteve të konstatuara, zgjidhjes së kontratës ose përjashtimit të përhershëm nga marrja e pagesave me financim nga qeveria italiane.

5.12. Mosrespektimi i një ose më shumë klauzolave etike nga konkurrenti ose fituesi i tenderit mund të sjellë përjashtimin e tyre nga kontrata të tjera të financuara, pjesërisht ose tërësisht, me fondet italiane të ndihmës për zhvillim, dhe zbatimin e sanksioneve të parashikuara në kontratë. Individi ose kompania përgjegjëse duhet të informohet me shkrim për faktin.

5.13. Autoriteti kontraktor siguron që procedurat për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve të kryhen në mënyrë transparente, bazuar në kritere objektive dhe të pavarura nga çdo ndikim i jashtëm.

Ndërkombëtar të Republikës Italiane - Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin Zhvillimor: dgcs5@esteri.it;

- për AICS - Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor, Romë, Itali:protocol.aics@pec.aics.gov.it.

Neni 19
HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nga dy njoftimet, me anë të të cilave Palët informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e aktiviteteve të projektit, pa paragjykuar mundësinë e Palëve për ta anuluar atë në përputhje me Nenin 15.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në ROMË. më ..13.11.2025., në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe italiane, me vlerë të njëjtë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS ITALIANE
Pirro Vengu	**Antonio Tajani**
Ministër i Mbrojtjes	**Minstër i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar**

Shtojcat:

1. Dokumenti i Projektit;
2. Klauzola etike dhe parime themelore për lidhjen dhe zbatimin e kontratave.